



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.295 /2024

Datë: 06.12.2024

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrta i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1 dhe nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 84, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimin Nr. 04-03/2024, nenin 13, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me numër protokollit 449, të datës 05.06.2024, të parashtruar nga subjektet e të dhënave, ndaj kontrolluesit z. B.B, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen si të bazuara ankesa me numër të protokollit 449, të datës 05.06.2024, të parashtruar nga subjektet e të dhënave ndaj kontrolluesit z. A.A, në cilësinë e kontrolluesi të të dhënave personale.
2. Urdhërohet, z. B.B në cilësinë e kontrolluesi të të dhënave personale, me adresë Rr. Hamit Bojniku, lagjja Ortakoll, Prizren, të ndaloj përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë, i cili është vendosur në hapësirën e përbashkët, pa bazë ligjore.
3. Obligohet kontrolluesi që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për zbatimin të këtij vendimi dhe të njoftoj Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 05.06.2024, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga subjekti i të dhënave z. A.A, i cili mbanë numrin e protokollit 449. Në ankesën e tij, subjekti i të dhënave ka shpjeguar se në shtëpinë në të cilën jeton me adresë Rr. Hamit Bojniku, lagjja Ortakoll , Prizren, sipas ndarjes fizike të shtëpisë, të realizuar përmes kontratës

noteriale LRP.nr.xxxxxx, Ref. Nr. xxx/2018 më datë 22.06.2018, të vërtetuar nga noteria C.C është pronar i 1/1 i katit të II-të e cila figuron edhe si banesë në emrin e tij personal, ndërsa në kati i parë është i vëllait me të cilin është në bashkëpronësi. Me këtë rast, në hyrjen e shtëpisë e cila është në bashkëpronësi me vëllain e tij z. B.B, ka vendosur kamerën në brenda në hyrje të përbashkët pa pëlqimin paraprak të tij. Ankuesi ka bashkangjitur edhe fotot si dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij.

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), përmes zyrtarëve të inspektimit, ka filluar shqyrtimin e ankesës. Bazuar në fotografitë e pranuar nga ankuesi Agjencia ka konstatuar se kontrolluesi ka vendosur sistemin e vëzhgimit me kamerë në hyrje të apartamentit të tij ku përfshihen shkallët e përbashkëta me ankuesin. Me këtë rast, zyrtari i inspektimit ka kontaktuar përmes telefonit me kontrolluesin, për ta njoftuar lidhur me pretendimet e ankuesit, pasi që i njëjti në kohën kur zyrtarët e inspektimit kanë planifikuar të realizojnë inspektim i njëjti ka qenë në orar të punës. Gjatë komunikimit përmes telefonit me kontrolluesin, nga i njëjti jemi njoftuar, sa ka të vendosur sistemin e vëzhgimit me kamerë në hapësirën e përbashkët në hyrje të apartamentit të tij, të cilën e ka vendosur për shkak të mosmarrëveshjes (incidentit) që kanë pasur me ankuesin dhe i njëjti nuk ka dëshmuar se ka pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave (ankuesit) për vendosjen e kamerës në hapësirën e përbashkët.

LMDhP në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’, me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, z B.B, cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LMDhP-së, me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, vëzhgimi me kamerë nënkupton marrjen dhe ruajtjen e të dhënave vizuale ose të tjera nga vendet e vëzhguara, ku personat fizikë lëvizin apo edhe qëndrojnë.

Për më tepër, vëzhgimi me kamerë nënkupton përpunimin e të dhënave personale gjatë regjistrimit të një personi fizik, në përputhje me përkufizimin e përpunimit të të dhënave personale të parashikuara në LMDhP. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, LMDhP në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LMDhP-së, përcakton se me përpunim nënkuptojmë çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi,

strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se mbledhja dhe regjistrimi i imazheve të marra nga sistemi i vëzhgimit me kamerë, përbënë përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë, ky përpunim duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

LMDhP në nenin 4, parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Njëri ndër këta parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në harmoni me ligjin.

LMDhP, lejon vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë për qëllim të sigurisë së njerëzve dhe sigurinë e pronës mirëpo, një gjë e tillë duhet bëhet gjithmonë në harmoni me dispozitat ligjore të parapara për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Nenit 75 paragrafi 2 të LMDHP-së, ka përcaktuar se personat që kanë për qëllim të vendosin sistemin e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftim për këtë (shenjë paralajmëruese), i cili duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'iu mundësojë subjekteve të të dhënave, që pa vështirësi, të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë. Në kuptimin e kësaj dispozite, kontrolluesi i të dhënave duhet të vendos shenjën njoftuese në rastin konkret në hyrje të ndërtesës.

Neni 77, i LMDhP-së, ka përcaktuar kriteret për mbikëqyrjen (vëzhgimin) e ndërtesave me apartamente. Paragrafi 1, i këtij neni ka përcaktuar se për instalimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë në ndërtesën me apartamente kërkohet pajtimi me shkrim e së paku shtatëdhjetë për qind (70%) të pronarëve. Paragrafi 2, i këtij neni ka përcaktuar se vëzhgimi me kamerë, mund të instalohet vetëm nëse kjo është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurinë e pronës. Paragrafi 3, i po këtij neni, ka përcaktuar se vëzhgimi me kamerë, në ndërtesën me apartamente mund të mbikëqyrë vetëm hyrjen dhe hapësirat e përbashkëta. Ndalohet mbikëqyrja më kamerë e apartamentit të shtëpiakut të ndërtesës dhe punëtorisë së tij ose saj. Paragrafi 4, gjithashtu i po këtij neni, ka përcaktuar se, ndalohen transmetimi i regjistrimeve të vëzhgimeve me kamerë përmes televizionit kabllor të të brendshëm, televizionit publik kabllor, internetit ose rrjeteve të tjera të telekomunikimit, pa marrë parasysh nëse bëhet në kohën e transmetimit apo më vonë.

Nenin 6, paragrafi i 1, i LMDhP-së, ka përcaktuar se, nëse përpunimi bazohet në pëlqim, kontrolluesi duhet të jenë në gjendje të dëshmojë, që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale.

Lidhur me kriterin e përcaktuar në neni 77, paragrafin 1, dhe bazuar në nenin 6, të LMDhP-së, duhet të theksohet se marrja e pëlqimit (pajtim) të shtatëdhjetë (70%) për qind të pronarëve të apartamenteve duhet të bëhet në harmoni të përkufizimit të shprehjes “pëlqim” sipas ligjit.

Neni 3, paragrafit 1, nën paragrafit 1.17, të LMDhP-së ka përcaktuar se: *“Pëlqimi i subjektit të të dhënave - nënkupton shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklaram ose*

me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të". Për të qenë në përputhje me ligjin, pëlqimi ashtu edhe siç u tha më lartë duhet të jetë i dhënë lirshëm që nënkuptojmë se subjekti i të dhënave nuk është i detyruar të pranojë një kërkesë të tillë ose do të durojë pasoja negative nëse nuk pranon; të jetë specifik - të jetë i qartë për subjektin e të dhënave të shpjegojë qëllimin e saktë të dhënies së pëlqimit dhe nëse ka informacione të përgjithshme, ai duhet të jetë i ndarë nga ato dhe të jetë i informuar që nënkuptojmë se për të qenë pëlqimi i vlefshëm duhet që personi të informohet para se ai të jap pëlqimin, edhe pse koha apo momenti i marrjes së pëlqimit nuk është e përcaktuar, nga gjuha e dispozitave nënkuptohet që ai duhet të merret para se të fillojë përpunimi i të dhënave.

Në këndvështrimin e këtyre dispozitave dhe duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, ku shtëpia është e ndarë në pjesë të barabarta, që sipas ndarjes figurojnë si banesa me hyrje të përbashkët (50/50%), Agjencia, konsideron se vendosja e sistemit të vëzhgimit me kamerë nga kontrolluesi, në korridorin e përbashkët, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që kontrolluesi nuk ka dëshmuar pëlqimin e marrë me shkrim të bashkëpronarit, meqë pjesa e pronës së kontrolluesit së të dhënave, është vetëm 50% dhe nuk mund të plotësojë kriterin e pëlqimit me shkrim të shtatëdhjetë (70%) për qind të pronarëve ashtu siç parashihet me dispozita ligjore.

Andaj, nga ajo që u tha më lartë, kontrolluesi me rastin e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë, duke mos marrë pëlqimin paraprak nga bashkëpronari (ankuesi) i ndërtesës, ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me nenin 77, paragrafin 1, nenin 5, paragrafi 1, të LMDhP-së.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit të ankesës, inspektimit të kryer dhe gjendjes faktike, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 06.12.2024]

Zyrtare e Inspektimit

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z. B.B,
- Palës ankuese,
- Arkivit të Agjencisë.